

Vendim nr. 236 datë 24.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 24.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (P) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: PËRPARIM KOVAÇI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1163/114 akti, datë 07.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; nr. 539 (30-2024-1870), datë 13.03.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2024-1501, datë 19.09.2024 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, shkronja “f” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar për veprën penale “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga nenet 143, paragrafi i dytë dhe 25 të Kodit Penal (KP) së bashku me një të pandehur tjetër, shtetasin M.M. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1558, datë 22.11.2013, ka vendosur, ndër të tjera, deklarinin fajtor të kërkuesit sipas akuzës dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim i bashkëpandehuri tjetër dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1122, datë 05.06.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë, me arsyetimin se nuk ishte respektuar procedura ligjore e njoftimit të të pandehurve.

2. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1093, datë 07.04.2016, ndër të tjera, ka vendosur sërish deklarinin fajtor të kërkuesit sipas akuzës dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim vetëm i bashkëpandehuri tjetër.

3. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit nr. 1093, datë 07.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr. 882 akti, datë 15.07.2016 të kësaj gjykate është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes, sepse kërkuesi ka hequr dorë nga shqyrtimi i kësaj kërkesë, pasi, për shkak të ankimit të bashkëpandehurit tjetër, çështja penale ndodhej për shqyrtim në gjykatën e apelit. Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1146, datë 30.04.2018, ka vendosur lënien në fuqi të tij. Nga materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual kundër këtij vendimi nuk rezulton të jetë bërë rekurs.

4. Për themelin e çështjes, bazuar në ankimin e të bashkëpandehurit tjetër, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 546, datë 07.04.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs edhe kërkuesi.

5. Ndërkohë, në datën 03.02.2020, kërkuesi është arrestuar dhe burgosur për efekt të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës së apelit. Gjatë kohës që rekursi për themelin e çështjes ka qenë në pritje për shqyrtim nga Gjykata e Lartë, në datën 28.02.2020 ai

ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit të dhëna në rigjykimin e çështjes së themelit, si dhe pezullimin e ekzekutimit të tyre, me pretendimin se gjykimi ishte zhvilluar në mungesë të tij. Kërkesa për rishikim është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 288 akti, datë 27.05.2020, me arsyetimin se çështja e kërkuarit nuk kishte përfunduar ende, pasi rekursi ishte në pritje për t'u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë. Nga materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual kundër këtij vendimi nuk rezulton të jetë bërë rekurs.

6. Për çështjen e themelit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1504, datë 22.11.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura, përfshirë edhe të kërkuarit. Sipas Gjykatës së Lartë, rekursi i kërkuarit nuk mund të pranohej, pasi ai nuk kishte paraqitur ankim në gjykatën e apelit, ndaj pretendimet e tij kishin rënë në dekadencë. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se është i pabazuar pretendimi kryesor i kërkuarit për padijeninë për gjykimin në gjykatën e apelit, duke evidentuar se referuar procesverbaleve të seancave gjyqësore, ai jo vetëm që është thirrur dhe ka pasur dijeni për gjykimin, por atij i është pranuar më shumë se një herë kërkesa për shtyrjen e seancës gjyqësore nga gjykata e apelit, e cila, në kushtet e mosparaqitjes së avokatit të zgjedhur prej tij, i ka caktuar mbrojtës kryesisht në respektim të së drejtës së mbrojtjes.

7. Kundër vendimeve gjyqësore të dhëna në procesin penal të themelit, në datën 12.04.2023 kërkuari ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*). Me vendimin nr. 126, datë 13.06.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare me arsyetimin se në kushtet kur kërkuari nuk ka ushtruar ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ai nuk ka shteruar mjetet e ankimit që ka pasur në dispozicion, ndaj nuk mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues.

8. Pas këtij vendimi, në datën 26.07.2023, kërkuari i është drejtuar sërish gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr. 1093, datë 07.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të lënë në fuqi me vendimin nr. 546, datë 07.04.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilin është vendosur mospranimi i rekursit me vendimin nr. 00-2022-1504, datë 22.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të dhëna në rigjykimin në themel të çështjes penale kundër tij.

9. Për këtë kërkesë, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr.1163/114 akti, datë 07.02.2024, ka vendosur rrëzimin e saj me arsyetimin se

rivendosja në afat lejohet vetëm në rastet kur i pandehuri është gjykuar pa praninë e tij sipas nenit 351 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), duke pasur dijeni për procesin, por që nuk ka marrë dijeni për vendimin përfundimtar të dhënë ndaj tij. Sipas kësaj gjykate, në rastin konkret, nuk ndodhemi përpara kushteve të rivendosjes në afat, por përpara rishikimit të vendimit të formës së prerë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

10. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 539 (30-2024-1870), datë 13.03.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me arsyetimin se kërkesa e kërkuesit është e përsëritur, pasi ai edhe më parë kishte kërkuar rivendosjen në afat për të njëjtin vendim dhe në rastin konkret ajo konsiderohet e paraqitur jashtë afatit ligjor 10-ditor nga dita që kërkuesi ka marrë dijeni efektivisht për vendimin nr. 1093, datë 07.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2024-1501, datë 19.09.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së.

12. Në datën 30.04.2025 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, duke kundërshtuar procesin gjyqësor për kërkesën e dytë të tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, të evidentuar në paragrafët 8-11 të këtij vendimi. Ky ankim kushtetues individual, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 30.06.2025. Për afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

13. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

- 13.1. Së drejtës së aksesit, pasi gjykatat kanë arsyetuar se kërkuesi ka humbur të drejtën për t’u rivendosur në afat, ndonëse ai ka ndjekur rrugën e zakonshme të ankimit në Gjykatën e Lartë dhe më pas në Gjykatë. Prandaj, në zbatim të

orientimeve të këtyre gjykatave, kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Për sa i përket kërkesës për rivendosjen në afat të paraqitur në vitin 2016 gjykata e shkallës së parë i ka sugjeruar kërkuar të heqë dorë, pasi çështja e themelit ishte për shqyrtim në gjykatën e apelit, ndërsa kërkesa për rishikim është pushuar për shkak se rekursi ishte ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

- 13.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, duke cenuar në këtë mënyrë edhe parimin e sigurisë juridike dhe pritshmërinë e ligjshme të kërkuar. Gjykatat kanë vendosur në kundërshtim me vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-1504, datë 22.11.2022 dhe atë të Kolegjit të Gjykatës nr. 126, datë 13.06.2023. Për më tepër, Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me praktikën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara në të cilat është vendosur se i gjykuari në mungesë ka të drejtë të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit. Për sa kohë kërkuar nuk ka paraqitur ankim dhe gjykata e apelit ka shqyrtuar çështjen vetëm mbi bazën e ankimit të të bashkëpandehurit tjetër, pra gjykimi për të ka mbetur në gjykatën e shkallës së parë, kërkuar i lindte e drejta për t'u rivendosur në afat për të drejtën e ankimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuar

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e

veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuksi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

15. Kërkuksi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Për sa i përket kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Kolegji vëren se për procesin gjyqësor që lidhet me kërkesën e tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Kolegji vëren se vendimi më i fundit që ka përmbyllur procesin e kundërshtuar nga kërkuksi është ai i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 19.09.2024, kurse ankimi kushtetues individual është dorëzuar në shërbimin postar në datën 30.04.2025. Ndërkohë, nga materialet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë i është komunikuar përfaqësuesit të kërkuksit në adresën elektronike në datën 30.12.2024. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

18. Në lidhje me kriterin e legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuksi ka pretenduar se vendimet gjyqësore që kanë vendosur për kërkesën e tij për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit, me argumentin se gjykatat kanë arsyetuar se ai ka humbur të drejtën për t’u rivendosur në afat, ndonëse ka ndjekur rrugën e zakonshme të ankimit, duke kërkuar rivendosjen në afat sipas orientimeve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës, si dhe së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me ligjin, me praktikën unifikuuese të kësaj gjykate që garanton të drejtën e të gjykuarit në mungesë për t’u rivendosur në afat. Në thelb, këto pretendime kanë të bëjnë me

mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar ligjin për kërkesën e kërkuarit për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë që ka dënuar kërkuarin me burgim dhe përgjigjen që Gjykata e Lartë u ka dhënë shkaqeve të rekursit të paraqitura nga kërkuari, mbi të cilin është vënë në lëvizje. Për rrjedhojë, Kolegji çmon të analizojë pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues individual në këndvështrim të *standardit të arsyetimit të vendimit*.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 42, datë 19.09.2023; nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pohuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuari është dënuar me burgim për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim, nga gjykata e shkallës së parë në vitin 2013. Çështja është kthyer për rigjykim nga gjykata e apelit me qëllim respektimin e procedurave të njoftimit. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim në vitin 2016 ka vendosur sërish deklarin e tij fajtor për kryerjen e veprës penale, vendim për të cilin ka paraqitur ankim vetëm i bashkëpandehuri tjetër. Gjatë kohës që çështja ishte për shqyrtim në gjykatën e apelit, kërkuari ka paraqitur kërkesë

për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për të cilën është vendosur rrëzimi, pasi kërkuesi ka hequr dorë nga shqyrtimi i kërkesës. Në vijim, gjykata e apelit në vitin 2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për dënimin e kërkuesit për kryerjen e veprës penale, për të cilin ai ka paraqitur rekurs. Në momentin kur kërkuesi është arrestuar dhe burgosur për efekt të ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit, ai ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të themelit, e cila është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë, duke konsideruar, në thelb, si të parakohshëm përdorimin e këtij mjeti, për sa kohë nuk kishte ende një vendim përfundimtar për themelin e çështjes, ndërsa rekursi i tij ishte në pritje për t'u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit, në vijim, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, ndërsa për ankimin e tij kushtetues individual Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në këto kushte, kërkuesi ka paraqitur përsëri kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit gjyqësor të shkallës së parë që e ka deklaruar fajtor dhe dënuar atë me burgim, të lënë në fuqi nga gjykatat më të larta në vijim.

22. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se rivendosja në afat lejohet vetëm në rastet kur i pandehuri është gjykuar pa praninë e tij sipas nenit 351 të KPP-së, duke pasur dijeni për procesin, por që nuk ka marrë dijeni për vendimin përfundimtar të dhënë ndaj tij. Sipas kësaj gjykate, kërkuesi ka pretenduar se hetimi dhe gjykimi i tij janë kryer në mungesë sipas nenit 352 të KPP-së, duke mos marrë dijeni personalisht për procesin gjyqësor penal përkatës të zhvilluar ndaj tij, por është përfaqësuar nga një avokat i caktuar kryesisht. Në këto kushte, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se nuk ndodhet përpara kushteve të rivendosjes në afat, por përpara rishikimit të vendimit të formës së prerë.

23. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me arsyetimin se kërkesa e kërkuesit për rivendosjen në afat të ankimit është paraqitur jashtë afatit ligjor 10-ditor nga dita kur ai ka marrë dijeni efektivisht për vendimin nr. 1093, datë 07.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sa kohë ai ka qenë në dijeni të këtij vendimi, së paku nga momenti kur ka paraqitur një kërkesë të tillë për herë të parë dhe për të cilën gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të heqjes dorë nga kërkuesi. Po sipas asaj gjykate, është i pabazuar në ligj pretendimi i kërkuesit se afati ligjor 10-ditor për paraqitjen e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit duhet të

fillojë nga vendimi i Kolegjit të Gjykatës (vendimi nr. 126, datë 13.06.2023), për sa kohë nuk është ajo data kur ai ka marrë efektivisht dijeni për vendimin për të cilin kërkon të rivendoset në afatin e ankimit. Megjithatë, vijon gjykata, edhe nëse do të merrej i mirëqenë ky pretendim, sërish kërkuksi është jashtë afatit ligjor 10-ditor për paraqitjen e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, pasi ai është njoftuar për vendimin e Kolegjit të Gjykatës në datën 26.06.2023 dhe kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit e ka paraqitur në datë 26.07.2023, pra jashtë afatit ligjor 10-ditor të parashikuar në nenin 420/1 të KPP-së. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuksi.

24. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuksit. Fillimisht, ai kolegji ka theksuar se qëllimi i institutit të rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit është garantimi i së drejtës themelore të ankimit dhe ushtrimit efektiv i saj dhe se sipas mjetit të veçantë të parashikuar nga neni 420/1 i KPP-së, pala që ka humbur afatin për të ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit gjyqësor, mund të vendoset në kushtet për ta ushtruar efektivisht këtë të drejtë, ndërkohë që humbja e afatit të ankimit ka lidhje me një situatë ose pengesë të paparashikuar, të pavarur nga vullneti i palës që ka humbur këtë afat. Në rastin konkret, vijon ai kolegji, kërkuksi është ndaluar në kuadër të ekzekutimit të vendimit penal të dënimit në datën 29.05.2019 dhe ai ka qenë në dijeni të këtij vendimi, për të cilin kërkon të rivendoset në afat, minimalisht nga data 04.11.2022 kur ka paraqitur kërkesën e parë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit. Megjithatë, kërkesa në rastin konkret për rivendosjen në afat të ankimit është paraqitur në datën 30.10.2023, pra jashtë afatit ligjor 10-ditor të parashikuar nga neni 420/1 i KPP-së, përveçse nuk verifikohet ndonjë rast faktor ose forcë madhore që e ka penguar atë në ushtrimin e së drejtës së ankimit në afat. Gjithashtu, sipas kolegjit, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara nga mbrojtësi në ankim, duke argumentuar vendimmarrjen e saj, pretendime që janë të njëjta me shkaqet e rekursit; nuk konstatohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit penal material apo procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk verifikohen shkelje ose zbatim i gabuar i ligjit procedural penal, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; nuk rezulton që vendimi i rekursuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, sipas Gjykatës së Lartë, rekursi nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së.

25. Në analizë të vendimeve gjyqësore objekt të ankimit kushtetues individual, Kolegji konstaton se gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit për kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, duke u dhënë atyre përgjigje të argumentuar. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka analizuar parashikimet ligjore për sa i përket kërkesës për rivendosjen në afat, duke arritur në përfundimin se ajo ishte paraqitur jashtë afatit, duke e llogaritur atë në përputhje me nenin 420/1 të KPP-së. Kjo gjykatë i ka kthyer përgjigje edhe pretendimit të kërkuarit se afati duhet të fillojë nga momenti i komunikimit të vendimit të Kolegjit të Gjykatës, duke arsyetuar se edhe në këtë rast kërkesa është paraqitur jashtë afatit. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se vendimet e atyre gjykatave kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit të tyre, ndërkohë që interpretimi nga ato i ligjit, i shprehur përmes arsyetimit, nuk duket i paarsyeshëm ose arbitrar, për sa kohë nuk evidentohet ndonjë gabim ligjor ose faktik i dukshëm.

26. Edhe për sa i përket vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se edhe pse është një vendim për mospranim rekursi, ai tregon vendimmarrjen e gjykatave të faktit, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, përveçse ka edhe një arsyetim të mjaftueshëm që mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, sikundër edhe analizës së bërë, Gjykata e Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuari është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në nenin 432 të KPP-së. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se kërkuari ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë për pretendimin kryesor, atë të rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit në përputhje me parashikimet ligjore dhe interpretimi i saj nuk rezulton kontradiktor, alogjik, i pamjaftueshëm, ose me kundërthënie. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.